

Hapet Thirrja për Bursa për Studentët në Universitetin e Foggia-s, Itali në kuadër të Programit Erasmus +

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019 në Universitetin e Foggia-s, Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;

- Master;

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor/Master (5 muaj);

Fushat e studimit:

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti i Foggia-s, klikoni në adresën:

<http://en.unifg.it/international/studying-unifg/incoming-student>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);

- Kostot e udhëtimit (Universiteti pritës do të mbulojë një kosto prej 180 Euro. Në rast se shuma do të tejkalohet, atëherë shtesa do të mbulohet nga vetë studenti).

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

➤ Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:

- CV

- Kopje e Pasaportës;

- Vërtetim studenti (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane);
- Listë notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2/Italisht);
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Foggia-s lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

➤ **Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane);
- Diplomë bachelor;
- Listë notash bachelor (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane);
- Listë notash master (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2/Italisht);
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Foggia-s lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloheni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti ‘Learning Agreement’ tek seksioni ‘Commitment’ firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe të skanuara në adresën e-mail: iro@unitir.edu.al.

Afati për aplikim: 5 Nëntor 2018

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!